



## VENDIM

Nr. 14 Datë 16.02.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KËRKESËS  
SË “EVN TRADING” SH.P.K, PËR HEQJEN E LICENSËS PËR  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR.  
179 SERIA T12 , MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 124, DATË 29.08.2012  
TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE.**

Në mbështetje të neneve 39 pika 1 dhe 42 pika 1 gërma dh të Ligjit nr. 43/2015, “Per sektorin e Energjise Elektrike”, Nenit 5.1 (g) te Liçences për Tregtim T12, Nenit 5 të Rregullores për Proçedurat e Heqjes së Liçensave, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike për heqjen e liçensës së shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 179 seria T12, miratuar me vendimin nr. 124, datë 29.08.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE,

### **Konstatoi se :**

- Shoqëria “EVN TRADING” sh.p.k, me shkresën nr.28 Prot, datë 06.01.2016, ka paraqitur në ERE një kërkesë për heqjen e liçensës për aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me nr.179, seri T12, miratuar me vendimi te Bordit te ERE-s nr. 124, datë 29.08.2012.
- Kërkesa e shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k., është e mbështetur në legjislacionin në fuqi, Neni 5, paragrafi i pare, i “Rregullores për Proçedurat e Heqjes së Liçensave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

## VENDOSI

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EVN TRADING” sh.p.k, për heqjen e licencës me nr.179 dhe numër serial T12, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 124, date 29.08.2012, për aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë te licencuarin lidhur me Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.